

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 65 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77 / 16 gusht 2010), nenin 20 paragrafi 20.1, nën paragrafi (d), nenin 21 paragrafi 21.2 dhe nenin 22 paragrafi 22.7, nën paragrafi (e) të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2019 miratoi:

RREGULLORE PËR PËRFITIMET PENSIONALE NGA PENSIONET PLOTËSUESE INDIVIDUALE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktojë udhëzimet për caktimin e përfitimeve që mund të ofrohen nga Ofruesit e Pensioneve, në mënyrë që marrëveshjet e tyre të pensioneve të jenë të qëndrueshme, të përballueshme dhe drejta.
2. Kjo Rregullore zbatohet për Ofruesit e Pensioneve që ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale, në pajtim me Kreun V të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-168 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (në vijim: Ligji për Fondet Pensionale) dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje:
 - 1.1. **Ofrues i Pensioneve ose Sigurues i Pensioneve** - nënkupton institucionet financiare, bankat, instrumentet për investime të hapura dhe kompanitë e sigurimeve që sigurojnë pensionet plotësuese individuale në pajtim me Ligjin për Fondet Pensionale.
 - 1.2. **Supozimet aktuariale** - nënkupton një numër të përlllogaritjeve financiare dhe demografike, që përdoren për të llogaritur kontributet e nevojshme për financimin e përfitimeve pensionale sipas marrëveshjeve të pensioneve me përfitime të caktuara (marrëveshje e pensionit me shuma të caktuara). Këto supozime përfshijnë mes tjerash, normat e interesit, rritjen ekonomike, shkallën e vdekshmërisë, shkallët e paaftësisë, shkallën e rritjes së pagave ose ndryshimet në kulturën e përgjithshme të kompensimit.
 - 1.3. **Pensioni invalidor** - nënkupton të drejtën për të filluar beneficionet e pensionit të përcaktuar sipas ligjit në fuqi, për pjesëmarrësin të cilit i është caktuar invaliditeti dhe që i jep asaj/atij të drejtën për pension invalidor.

- 1.4. **Pensioni i shtyrë** - nënkupton përfitim pensional për të cilin pjesëmarrësi ka të drejtat e fituara me ndërprerjen e punësimit para moshës së pensionit mirëpo ky përfitim shtyhet deri në moshën e pensionimit.
- 1.5. **Mosha e pensionit** - nënkupton moshën 65 vjeçare.

Neni 3

Përfitimet Pensionale nga Programi i Pensionit me Shuma të Caktuara

1. *Bazat për përcaktimin e përfitimeve të pensionit.* Rregullat e pensionit duhet të përcaktojnë qartë shumën e përfitimeve të pensionit në tabelën e përfitimeve, bazuar në Supozimet Aktuariale e cila merr parasysh elementet si në vijim:
 - 1.1 vlerën e kontributit të dëshiruar.
 - 1.2 numrin e viteve ose muajve për të paguar kontributet.
 - 1.3 moshën e pjesëmarrësit.
 - 1.4 tabelën e mortalitetit ose shkallët e shfrytëzuara për përcaktimin e mortalitetit.
 - 1.5 normat e interesit të garantuara dhe nëse aplikohen normat e supozuara të interesit.
 - 1.6 metoda e indeksimit dhe indeksi i referencës së përdorur, nëse ka.
2. *Të Drejtat e fituara për përfitim pensionit.* Rregullat e pensionit që ofrojnë pensionin me suma të caktuara duhet të përfshijnë Tabelën e Përfitimeve të Pensioneve, që prezantojnë periudhat specifike të pjesëmarrjes. Vlera/shuma e përfitimeve pensionale në fund të çdo periudhe duhet kualifikuar si e drejtë e fituar. Vlera/shuma si e drejtë e fituar mund të zbritet në shumën e tarifës e vendosur nga Ofruesit e Pensioneve, nëse janë plotësuar kërkesat si në vijim:
 - 2.1 vlera/shuma e tarifave të tilla është caktuar në rregullat e pensionit.
 - 2.2 pjesëmarrësi transferon të drejtat e tij të fituara.
 - 2.3 tarifat janë ngarkuar dhe mbledhur nga Ofruesi i Pensionit në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. *Zvogëlimi, suspendimi ose ndërprerja e kontributeve.* Rregullat e pensionit duhet të sigurojnë që pjesëmarrësit të kenë mundësinë të zvogëloj, suspendojnë ose ndërprejnë kontributet, si dhe duhet qartë të specifikojë metodologjinë e rregullimit të përfitimeve të pensionit në rast se ndonjëra prej këtyre ndodh. Rregullat e pensionit duhet ta caktojnë të drejtën e pjesëmarrësit që të transferojë të drejtat e tij/saj të fituara në program tjetër të pensionit.
4. *Përfitimi i pensionit invalidor.* Nëse pensioni invalidor përfshihet si përfitim në rregullat e pensionit, vlera e pensionit invalidor (duke marrë parasysh shkallën e invaliditetit) duhet të jetë, shumë fikse ose shumë fikse dhe e indeksuar për të përfshirë rregullimin me ndryshimet në koston e jetesës. Pensioni invalidor duhet të paguhet deri në datën e përfundimit të pensionit invalidor ose pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit.
5. *Përfitimi i bashkëshortit që jeton.* Nëse pjesëmarrësi që është i martuar vdes para moshës së pensionimit, përfitimi nga pensioni i tij bëhet përfitim i pensionit të shtyrë për bashkëshortin e tij. Rregullat e pensionit mund të përcaktojnë forma tjera të përfitimimit për bashkëshortin që jeton.

6. *Pagesa për përfituesit e pensionit.* Nëse pjesëmarrësi vdes para moshës së pensionimit, por që nuk ka bashkëshort, të drejtat e fituara duhet t'i paguhen përfituesve të caktuar nga pjesëmarrësi. Rregullat e pensionit duhet të specifikojnë mënyrën si dhe procedurat për pagesat për përfituesit.
7. *Pagesat e përfitimeve pensionale.* Pensionet duhet të paguhen në baza mujore si vlerë fikse ose e përcaktuar në pajtim me tabelën e përfitimeve që është pjesë e rregullave të pensionit.
8. *Përfitimet e pensionit të shtyrë.* Pjesëmarrësi i cili e ndërprente pagesën e kontributeve, Drejtat e Fituara në Fondin Pensional mbesin si pension i shtyrë. Pagesa e pensionit fillon në moshën e pensionit. Nëse një individ i cili ka pension të shtyrë vdes para fillimit të pagesës së pensionit, përfitimet e pensionit të shtyrë do të paguhen në pajtim me rregullat e pensionit, duke respektuar të drejtat e pjesëmarrësit në rast të vdekjes.
9. Pjesët e një (1) viti të pjesëmarrjes, do të numërohen në baza proporcionale në përcaktimin e përfitimeve dhe kontributeve të pensionit.
10. BQK-ja mund të përcaktojë kërkesa tjera të aplikueshme për subjektet që ofrojnë Pensione Plotësuese Individuale.

Neni 4

Përfitimet Pensionale nga Programi i Pensionit me Kontribute të Caktuara

1. *Bazat në përcaktimin e përfitimit të pensionit.* Rregullat e pensionit duhet të sigurojnë që përfitimi i pensionit do të jetë shuma e mjeteve, të alokuara në pasqyrën e llogarisë individuale të pjesëmarrësit sipas vlerësimit të muajit të fundit para fillimit të pensionit, e llogaritur dhe e përcaktuar në pajtueshmëri me Rregulloren mbi Llogaritë Individuale të Pjesëmarrësve. Shuma e mjeteve në llogarinë individuale të pjesëmarrësve përbëhet prej:
 - 1.1 gjithsej kontributet e bëra nga pjesëmarrësi gjatë gjithë periudhës së kontributeve të tij;
 - 1.2 kthimet nga investimet e alokuara në shumën totale të përcaktuar në nënparagrafin 1.1. të këtij paragrafi.
2. *Shuma e përfitimit mujor të pensionit.* Ofruesi i Pensionit duhet të blejë një kontratë anuiteti nga kompanitë e sigurimit të jetës, në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregullative për të paguar për pensionet mujore. Shuma e pensioneve mujore përcaktohet nga:
 - 2.1 shuma e mjeteve në llogarinë individuale të pjesëmarrësit, në datën e pensionit.
 - 2.2 moshës së pjesëmarrësit; dhe
 - 2.3 opsionin e përzgjedhur të pagesës apo shlyerjes.
3. *Të drejtat e fituara.* Të drejtat e fituara të pjesëmarrësit në pensionin me kontribute të caktuara janë të barabarta me shumën e mjeteve të alokuara në llogarinë individuale të tij sipas datës së fundit të vlerësimit.
4. *Përfitimi i pensionit invalidor.* Nëse pensioni invalidor përfshihet si përfitim në rregullat e pensionit, vlera e pensionit invalidor (duke marrë parasysh shkallën e invaliditetit) duhet të jetë shumë fikse ose shumë fikse dhe e indeksuar për të përfshirë rregullimin me ndryshimet në koston e jetesës. Pensioni invalidor duhet të paguhet deri në datën e përfundimit të pensionit invalidor ose pjesëmarrësi ka arritur moshën e pensionit.

5. *Përfitimi i bashkëshortit që jeton.* Nëse pjesëmarrësi që është i martuar vdes para moshës së pensionit, përfitimi i pensionit i barabartë me të drejtat e fituara (bilanci i llogarisë individuale) sipas datës së fundit të vlerësimit para muajit të vdekjes caktohet si përfitim pensional i shtyrë për bashkëshortin që jeton.
6. *Pagesa e përfitimeve të pensionit.* Pensionet duhet të paguhen në baza mujore përmes kontratës së anuitetit të fondi pensional sipas udhëzimit të pjesëmarrësit.
7. *Përfitimi i pensionit të shtyrë.* Pjesëmarrësi i cili e ndërprente pagesën e kontributeve, që të Drejtat e Fituara në Fondin Pensional mbeten si pension i shtyrë. Pagesa e pensionit fillon në moshën e pensionit. Nëse një individ i cili ka pension të shtyrë vdes para fillimit të pagesës së pensionit, përfitimet e pensionit të shtyrë do të paguhen në pajtim me rregullat e pensionit, duke respektuar të drejtat e pjesëmarrësit në rast të vdekjes.

Neni 5

Zbatimi, masat korigjuese dhe dënimet civile

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje do të shfuqizohet Rregulla 18 mbi Benefitet e Pensionit Programet e Aplikueshme të Pensioneve Suplementare Individuale, e datës 23 tetor 2002.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës